



EDUKIMI MJEDISOR



Shtator 2024

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

“E vetmja rrugë nëse do të përmirësojmë cilësinë e mjedisit, është përfshirja e të gjithëve”

Richard Rogers

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura** paraqet aktivitetet e zhvilluara nga **12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura**, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit **shtator 2024**. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **390**

26 Shkolla të përfshira

Specialistë të angazhuar **24**

26 Mësues të përfshirë

Orë mjedisore të realizuara **26**

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



11 shtator 2024, ekspeditë në natyrë

Specialistët e AdZM-së Shkodër mirëpritën në qendrën e vizitorëve në Velipojë, pjesë e Peizazhit Ujor Tokësor të Mbrojtur “Lumi Buna - Velipojë” përfaqësues të Qendrës Eden, profesorë si dhe studentë të Universiteve “Eberswalde” Gjermani, Universiteti Aristotel dhe Universiteti i Janines në Greqi, Universiteti i Tiranës në Shqipëri, Universiteti i Prishtinës në Kosovë, Universiteti i Podgorices në Malin e Zi, Universiteti i Shkupit në Maqedonin e Veriut. Gjatë kësaj vizite të pranishmit u njohën dhe morën informacione nga stafi i AdZM Shkodër për zonën e Peizazhit Ujor Tokësor të Mbrojtur “Lumi Buna - Velipojë” me territoret ligatinore përreth saj dhe jo vetëm. Pas vizitës në qendrën e vizitorëve u zhvillua dhe një shëtitje në natyrë në kullën e vrojtimit dhe grykëdredhjen e Lumit Bunë.

21 shtator 2024, Dita Ndërkombëtare e Pastrimit të Bregdetit

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Pastrimit të Bregdetit, në bashkëpunim me nxënës dhe mësues të shkollës 9-vjeçare “Gjergj Vatë Martini”, specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një aksion pastrimi në Plazhin e Velipojës, pjesë e Peizazhit Ujor Tokësor të Mbrojtur “Lumi Buna - Velipojë”. Duke u pajisur me mjetet e nevojshme, u arrit të pastrohej një pjesë tepër e konsiderueshme në këtë zone. Kështu nxënësit kuptuan se të gjithë së bashku mund të kujdesemi dhe të kontribuojmë për një mjedis më të pastër.

27 shtator 2024, Dita Ndërkombëtare e Turizmit

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Turizmit u zhvillua një orë mjedisore me nxënës të shkollës 9-vjeçare “Vasil Shanto” Vrakë, pjesë e Rezervatit Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës”. Gjatë kësaj ore mjedisore së bashku me nxënësit u diskutua mbi turizmin në zonat e mbrojtura, numrin e lartë të turistëve (vendas dhe të huaj), rëndësinë si dhe sfidat e tij. Kështu nxënësit arritën të njihen me tepër me zonat e mbrojtura që ndodhen në rajonin e Shqipërisë.

aksion pastrimi

zona të mbrojtura

shëtitje në natyrë

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



11 qershor 2024, orë mjedisore

Në kuadër të edukimit mjedisor me shkollat stafi i AdZM-së Kukës në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Krumë” zhvilluan një orë mjedisore. Nxënësit e klasës së 5-të të kësaj shkolle u njohën me vlerat natyrore të zonës dhe të monumenteve të natyrës të Bashkisë Has. Në përfundim të kësaj ore mjedisore, nxënësit realizuan disa piktura të natyrës dhe të monumenteve që ndodhen në këtë zonë.

30 shtator 2024, Dita Botërore e Turizmit

Në kuadër të Ditës Botërore të Turizmit, specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një prezantim me nxënësit e shkolles 9-vjeçare “Shishtavec” mbi rëndësinë e kësaj dite si edhe mundësitë e zhvillimit të turizmit në zonat e mbrojtura , të gjitha këto të shpjeguara nga një kumtes e mbajtur nga specialistët e AdZM Kukës. Mesazhi i përçuar tek nxënësit ishte që të gjithë së bashku të ruajmë dhe të kujdesemi për të mbajtur pastër mjedisin i cili na rrethon.



monumente natyre

zhvillim i turizmit

piktura



13 shtator 2024, Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Shtresës së Ozonit

AdZM Dibër realizoi një orë mjedisore në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Mbrojtjes së Shtresës së Ozonit. Me anë të një ilustrimi, nxënësit u informuan rreth shtresave të atmosferës, rëndësinë që ka shtresa e ozonit për planetin tonë si dhe shkaqet që çojnë në hollimin e shtresës së ozonit. Nxënësit mësuuan se si mundet që secili prej nesh të ndihmojë në mbrojtjen e shtresës së ozonit. Kështu të gjithë së bashku mund të mbrojmë natyrën.

“EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



biçikleta harmoni me natyrën

turizmi i qëndrueshëm



23 shtator 2024, Dita Botërore e Lëvizjes pa Makina

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit stafi i AdZM Lezhë ka zhvilluar me nxënësit e shkollës së mesme “Ishull Lezhë” një ecje në natyrë dhe një shëtitje me biçikleta përgjatë Lagunës së Vainit në kuadër të Ditës Botërore pa Makina. Nënësit u njohën me simbolikën e kësaj dite dhe përse ne duhet të theksojmë rëndësinë e përdorimit të mjeteve alternative të transportit. Dita Botërore pa Makina është një ditë mjaft e rëndësishme për mjedisin dhe ka për synim sensibilizimin e njerëzve që të paktën në një ditë të vitit t’i largohen makinave të tyre, të cilat çlirojnë gaze të dëmshme për organizmin tonë. Qëllimi ynë është pikërisht ndërgjegjësimi për të mundësuar sa më shumë lëvizjen me mjete sa më miqësore me mjedisin.

26 shtator 2024, Dita Botërore e Shëndetit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mjedisor stafi AdZM Lezhë ka zhvilluar me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Gjovalin Gjadrë” një orë mjedisore ku u diskutua në lidhje me rëndësinë e kësaj dite si dhe për të ruajtur dhe përmirësuar mjedisin. Me fjalë të tjera, edukimi mjedisor është hartuar për të na mësuar se si të jetojmë në harmoni me natyrën dhe të zvogëlojmë ndikimin njerëzor në mjedis. Fëmijët përgatiten postera dhe zhvilluan pyetësorë të ndryshëm në klasë. Qëllimi ynë është të nxisim aktivitete dhe aksione për të arritur ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit dhe njëkohësisht ndërgjegjësimin e brezave të rinj.

27 shtator 2024, Dita Botërore e Turizmit

Specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan me nxënësit e shkollës Profesionale “Kolin Gjoka” të degës Turizëm një prezantim mbi rëndësinë e Ditës Botërore të Turizmit dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit në zonat e mbrojtura. Nxënësit u njohën me disa informacione në lidhje me zonat e mbrojtura më të vizituara, mundësinë për të promovuar akoma më shumë këto zona dhe statistika mbi numrin e turistëve që kanë vizituar zonat e mbrojtura. Në fund të orës i shpërndamë nxënësve fletëpalosje, broshura dhe materiale të disa zonave të mbrojtura që AKZM-ja menaxhon. Është e rëndësishme të promovojmë turizmin e qëndrueshëm duke u kujdesur për mjedisin dhe respektuar kulturën dhe trashëgiminë e çdo destinacioni që vizitojmë.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



26 janar 2024, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mjedisit, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një sesion informues me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Mustafa Myrteza Kaçaçi” Nojë, Krujë. Gjatë kësaj ore mjedisore, nxënësit fillimisht u njohën me konceptin e mjedisit dhe rëndësinë e tij. Në formën e pyetje – përgjigje diskutuam në lidhje me hapat dhe veprimtaritë që duhet të ndjekë secili nga ne për të mbrojtur mjedisin që na rrethon. Nxënësit kishan postera me mesazhe sensibilizuese: të mbjellim pemë, të kursejmë ujin, të kursejmë energjinë dhe të përdorim energji të rinovueshme, të hedhim mbetjet në koshat përkatës, të riciklojmë etj.

27 shtator 2024, Dita Botërore e Turizmit

Dita Botërore e Turizmit, festohet më 27 shtator, na sjell një rast për të reflektuar mbi rëndësinë e udhëtimëve në ekonominë globale, kulturën dhe mjedisin. Turizmi është më shumë se një udhëtim, është një mënyrë për të zbuluar pasurinë natyrore dhe kulturore të çdo vendi dhe për tu kujdesur për planetin tonë. Nxënësit e klasës së 6-të të shkollës 9- vjeçare “Xhelal Shtufi” në Shkafane, u njohën me të gjitha këto informacione nga specialistët e AdZM Durrës.



24 shtator 2024, ecje në natyrë

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Bahri Nela” u bënë pjesë natyrës duke u njohur më nga afër me bukuritë natyrore që Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” ofron. Nxënësit gjatë ecjes në natyrë u përfshinë në diskutime mbi rëndësinë dhe mbrojtjen e mjedisit, u zbavitën me lojëra informuese ndërkohë që patën dhe mundësinë e vrojtimit të shpendëve të egër me ndihmën e dylbive. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte eksplorimi i natyrës dhe njohja e biodiversitetit të larmishëm të zonës së mbrojtur të Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit.”

27 shtator 2024, Dita Botërore e Turizmit

Specialistët e AdZM Tiranë realizuan një orë të hapur mjedisore me nxënësit e e klasës së 6-të të shkollës 9-vjeçare “Tufinë”, Tiranë. Nxënësit u njohën me rëndësinë e Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit”, me vlerat e tij kulturore, historike e tradicionale që ofron mundësi të shkëlqyera për aktivitete sportive dhe edukuese. Këto elementë e bëjnë këtë park një destinacion turistik mjaft të vizituar nga turistë të huaj përgjatë gjithë vitit duke çuar dhe në zhvillimin e turizmit malor. Ky aktivitet u pasua dhe me një aksion pastrimi për një mjedis më të pastër.



21 shtator 2024, Dita Botërore e Shëndetit Mjedisor

Në bashkëpunim me nxënësit e shkollës së mesme të Bashkuar “Isak Alla”, Zgosht, në afërsi të Parkut Kombëtar “Shebenik”, specialistët e AdZM Elbasan realizuan një aktivitet pastrimi. Nxënësit e realizuan këtë aktivitet pastrimi në ambientet e shkollës dhe zonës rreth saj, duke u informuar edhe për pasojat e ndryshme që shkakton ndotja, si dhe masat që duhet të merren për kujdesin dhe mbrojtjen e mjedisit. Të kujdesemi për mjedisin ku jetojmë duke e mbajtur pastër atë, ishte mesazhi i përçuar tek nxënësit.



04 shtator 2024, orë mjedisore

Stafi i AdZM-së Fier zhvilloi një orë mjedisore me të rinjtë e Kampit Veror "Urban Lab", Divjakë. Ata u njohën me vlerat natyrore të Parkut Kombëtar "Divjakë-Karavasta", për florën, faunën dhe veçoritë e këtij parku. Nëpërmjet konkurseve midis grupeve të rinjtë testuan njohuritë e marra nga specialistët e AdZM-së.

18 shtator 2024, Dita Botërore e Monitorimit të Ujit

Në kuadër të Ditës Botërore të Monitorimit të Ujit stafi i AdZM Fier së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Mizë" në Divjakë, realizuan sot një shembull konkret mbi mënyrën e monitirimit të cilësisë së ujit.

18 shtator 2024, Dita Ndërkombëtare e Pastrimit të Bregdetit

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Pastrimit të Bregdetit, AdZM Fier në bashkëpunim me Bashkinë Divjakë, institucionet lokale dhe arsimore, qytetarë, vullnetarë e shumë të rinjë që realizuan një punë të shkëlqyer në terren.

“EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



26 shtator 2024, Dita Botërore e Shëndetit Mjedisor

Ne kuadër të kësaj dite është realizuar një aksion pastrimi në territorin e zonave të mbrojtura, në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit". Në këtë formë arrijmë të edukojmë dhe të ndërgjegjësojmë për të mbajtur pastër mjedisin ku ne jetojmë ose vizitojmë.

27 shtator 2024, Dita Botërore e Turizmit

Me rastin e Ditës Botërore të Turizmit me nxënësit e shkollës "Myslym Bakeri" në Bogovë u improvizua një guidë turistike të cilës ju bashkua stafi i AdZM Berat dhe turistë të cilët ndodheshin në zonë, duke mësuar më tepër rreth karakteristikave të parkut dhe duke shijuar njëkohësisht bukuritë e natyrës.

guida turistike

bukurit e natyrës

mjedis i pastër

“EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



16 shtator 2024, Dita Botërore e Mbrojtjes së Shtresës së Ozonit

AdZM Gjirokastrë në bashkëpunim me shkollën 9 vjeçare "Nonda Bulka", zhvilluan orë mjedisore në kuadër të Ditës Botërore të Mbrojtjes së Shtresës së Ozonit.

Nxënësit u informuan rreth rëndësisë që ka kjo shtresë për planetin Tokë si edhe cilët janë shkaqet që çojnë në hollimin e kësaj shtrese. Në fund të orës mjedisore nxënësit u informuan mbi hapat që secili prej nesh duhet të ndjekë për të mbrojtur shtresën e ozonit.

26 shtator 2024, Dita Botërore e Shëndetit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Mjedisor, AdZM Gjirokastrë realizoi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Koco Shukalari". Kjo datë synon inkurajimin dhe ndërgjegjësimin dhe veprimin në mbarë botën për mbrojtjen e mjedisit. Ata shprehën dëshirën të bëhen pjesë duke mbjellë në mënyrë aktive pemë, duke u angazhuar në riparimin e mjedisve që janë degraduar nga aktivitete si ndotja dhe shpyllëzimi, duke ruajtur dhe promovuar ekosistemet që janë ende të paprekura.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



18 shtator 2024, orë mjedisore

12 nxënës të klasës së 9-të të shkollave “Dy Dëshmorët” në Pustec morën pjesë në aktivitetin e festimeve për “Ditët e Brezit të Gjelbër”. Ky aktivitet u zhvillua në bashkëpunim me PPNEA ku u theksua rëndësia e kësaj nisme bashkëpunimi midis vendeve të Ballkanit. Nëpërmjetë kësaj nisme, mesazhi i përçuar tek nxënësit ishte promovimi i mjeteve të qëndrueshme të jetesës, ruajtja e burimeve natyrore si dhe nxitja e bashkëpunimit dhe edukimit të brezave të rinj.

19 shtator 2024, orë mjedisore

AdZM Korçë në bashkëpunim me PPNEA organizuan një aktivitet mbi eksplorimin dhe monitorimin e jetës së egër, ku u ndanë rezultatet nga monitorimi i faunës, përfshirë lloje shumë të rrezikuara si rrëqebulli i Ballkanit. Nxënësit morën pjesë në një seancë praktike, ku mësuan si të instalojnë kamerat kurth, duke përfshirë pjesën teknike e më tej përzgjedhjen e vendndodhjeve, vendosjen e kamerave kurth, kontrollin e rregullt dhe analizën e të dhënave.

ekosistem lokal peizazh ligatinor

edukim i brezave të rinj

20 shtator 2024, orë mjedisore

15 nxënës të shkollës 9-të vjeçare "Raif Kolami" në Tren u bashkuan me stafin e AdZM Korçë për një përvojë të edukimit mjedisor, ku krijimtaria dhe të nxënës u ndërthurën në mënyrë të përkryer. Detyra e tyre ishte të ndërtonin habitatet e pasura dhe komplekse të Ligatinës së Prespës së Madhe, e cila strehon shumëllojshmëri shpendësh. Duke përdorur materiale artistike, hartat dhe udhëzimet e ekspertëve të PPNEA, AdZM Korçë dhe mësueses të lëndës së biologjisë, nxënësit u angazhuan në një aktivitet praktik që i lejoi ata të rikrijonin peizazhin e ligatinës me elementë të rëndësishëm si burimet ujore, bimësinë dhe zonat kryesore të folezimit.

23 shtator 2024, orë mjedisore

Në kuadër të nismës BalkanianRoute, për Ditët Evropiane të Brezit të Gjelbër, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën fillore të Zvezdës me fokus mbi florën. Nxënësit mësuan për specie të ndryshme bimësh të cilat gjenden në Parkun Kombëtar të Prespës dhe si ato mbështesin gjithë ekosistemin. Nxënësit krijuan edhe zinxhirin ushqimor nëpërmjet vizatimeve të ndryshme. Të ruajmë dhe ndërgjegjësohemi për florën dhe natyrën që na rrethon si një pasuri e veçantë që ne kemi, ishte mesazhi i përçuar tek nxënësit nëpërmjet kësaj ore mjedisore.

24 shtator 2024, orë mjedisore

25 nxënës nga shkollat e mesme "Dy dëshmorët" në Pustec dhe "Abdulla Progri" në Progër, prezantuan idetë e tyre për të formësuar të ardhmen e ekoturizmit. Ata diskutuan mbi sfidat e së shkuarës, pengesat aktuale duke propozuar zgjidhje kreative për të çuar përpara këtë sektor kaq të rëndësishëm. Më pas vizituan fshatin Goricë e Vogël për një ekspeditë në terren ku nxënësit morën pjesë në monitorimin e shpendëve të ujit si çafkat dhe karabullakët, duke mësuar nga afër për rolin e tyre jetik në ekosistemin lokal. Ekoturizmi në Prespë luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e biodiversitetit të pasur dhe trashëgimisë kulturore të rajonit, duke promovuar një zhvillim miqësor me mjedisin për komunitetin lokal.